



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 22, datë 29.05.2019

MBI

“PËRCAKTIMIN E PIKËZIMIT NË KONKURSET E PRANIMIT PËR CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE DHE CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË NË UNIVERSITETIN E ARTEVE, PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020”

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 38, nenin 74, 76 e vijim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; nisur dhe nga propozimet e Fakulteteve të Universitetit të Arteve, bashkëlidhur këtij vendimi dhe më konkretisht shkresave të Fakultetit të Muzikës me nr. 38/2 prot., datë 10.05.2019 (protokolluar në Rektorat me nr. 89/1 datë 10.05.2019), Fakultetit të Artit Skenik me nr. 103 prot., datë 29.01.2019 (protokolluar në Rektorat me nr. 163 datë 29.01.2019) dhe të Fakultetit të Arteve të Bukura me nr. 25 dhe 25/1 prot., datë 16.02.2019 dhe pasi e diskutoi me votim të hapur,

V E N D O S I:

1. Pikët maksimale për konkurrim në një nga programet e studimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor në Fakultetet e Universitetit të Arteve të jenë **200 pikë**, me këtë ndarje:
 - a) 30% e totalit ose **60 pikë** i takojnë notës mesatare të viteve të shkollimit dhe provimeve të Maturës Shtetërore;
 - b) 70% e totalit ose **140 pikë** i takojnë rezultateve të konkursit të pranimit për secilin program të ofruar nga Universiteti i Arteve;
2. Kufiri minimal i pranimit të konkurrentëve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor të jetë **90 pikë**.
3. Formula e llogaritjes së pikëve të konkursit të pranimit në Universitetin e Arteve për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor në vitin akademik 2019-2020, të jetë si më poshtë:

- | | | |
|---------------|---|--|
| a) P | Pikët e përgjithshme për konkurrim: | 200 totali |
| b) NMP | Nota mesatare e përgjithshme ose 30 % e totalit të pikëve: | 60 pikë |
| c) PK | Pikët e konkursit të pranimit ose 70 % e totalit të pikëve: | 140 pikë |
| d) | Formula e llogaritjes së pikëve: | $P = (NMP/60 \times 0.3 + PK/140 \times 0.7) \times 200$ |



4. Pikët maksimale për konkurrim në një nga programet e studimit në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë Master i Arteve/ Master Shkencor, dhe Master Profesional në Fakultetet e Universitetit të Arteve të jenë **100 pikë**.
5. Ndarja e pikëve për Fakultetin e Artit Skenik dhe Fakultetin e Arteve të Bukura të jetë si më poshtë:
 - a) Nota mesatare e ponderuar: **30** (tridhjetë) pikë;
 - b) Vlerësimi i dosjes personale: **30** (tridhjetë) pikë;
 - c) Bashkëbisedim me kandidatin: **40** (dyzet) pikë;
6. Ndarja e pikëve në Fakultetin e Muzikës për secilin program studimi të ofruar, në përkatësi të elementeve kryhet nga komisioni i vlerësimit.
7. Kufiri minimal i pranimit të konkurrentëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë Master i Arteve/ Master Shkencor, dhe Master Profesional të jetë **40 pikë**.
8. Ky vendim të dërgohet pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
9. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve, në portalin U-Albania dhe tek transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Dr. Zana SHUTERIQI (PRELA)

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Asoc. Ardian ISUFI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Gazmend GJOKA



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

Prof. Petrika AFEZOLLI

Prof. Bujar SYKJA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Asoc. Elvis RUDI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Asoc. Genc MULLIQI

Urim ALIAJ

Rajmond PRENDUSHI